



C.nr.295/13

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm ,Divizioni Civil, gjyqtari Alban Beqiri, me sekretaren juridike Lendita Pajaziti, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj të cilin e përfaqëson me autorizim av. [REDACTED] kundër të paditurit [REDACTED] ish nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj tani me adresë të panjohur të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme av. [REDACTED] në çështjen juridike vërtetimi i të drejtës së pronësisë, pas seancën kryesore publike të mbajtur më 03.01.2018, mori, kurse me dt.15.01.2018, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I APROVOHET në tërësi kërkesë padia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj e paraqitur kundër të paditurit [REDACTED] ish nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, **si e bazuar.**

II VËRTETOHET se paditësi [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, është pronar i patundshmërive dhe atë NK.nr.1202-2, në sipërf. prej 1.84.07 ha, NK.nr.1156-1 në sipër prej 0.65.10 ha², dhe NK.nr.1156-2 në sipër faqe prej 0.52.49 ha këto ngastra gjendet në vendin e quajtur "Utrina" ZK. Prelez i Jerlive.

III DETYROHET i padituri [REDACTED] ish nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, që t'ia pranoj paditësit të drejtën e pronësisë, të përshkruar si në pikën II të dispozitivit dhe t'ia bartë në emrin e tij në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim, pas plotfuqishmërisë paditësit do ti shërbej si dëshmi tabulare për bartjen e pronësisë në drejtorinë për gjeodezi dhe kadastër në Komunën e Ferizajt, pa prezencën e të paditurit.

IV DETYROHET paditësi që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 1,536 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka deklaruar se mbetëm në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë parashtrësës mbi precizimin e padisë e dt.05.12.2017, thënieve të cekura në seancat e kaluara, duke shtuar se nga administrimi i provave është vërtetuar se paditësi nga i padituri i ka blerë patundshmëritë kontestuese në vitin 1981 sipas marrëveshjes gojore sipas çmimit kontraktues prej 10.000DM, dhe që nga ajo kohë është futur në posedim të qetë dhe me mirëbesim.

Njëherit ka shtuar se kjo është vërtetuar me dëgjimin e dëshmitarëve daljes së gjykatës në vendin kontestues s'bashku me ekspertin e gjeodezisë, por meqenëse paditësi ka qenë me punë të përkohshme në Gjermani këto prona sipas dëgjimit të dëshmitarëve i njëjti i ka lëshuar me qira personave që kanë pasur nevojë siç është edhe [REDACTED] që tani i shfrytëzon.

Sa i përket vërejtjeve të dhëna nga ana e përfaqësueses së të paditurës në lidhje me atë se familjarët nuk kanë mundur me saktësi të bëjnë identifikimin e ngastrave kontestuese ka theksuar se meqenëse paditësi s'bashku me familjen e tij jeton dhe vepron në shtetin e Gjermanisë që një kohë të gjatë dhe si rezultat i të cilave nuk ka qenë e mundur të bëhet me saktësi të bëhet identifikimi i njërës ngastrës kontestuese, kjo për faktin se paditësi është në gjendje të rëndë shëndetësore dhe nuk ka mundur të jetë prezent në asnjërën seancë gjyqësore dhe as në vendi kontestues e për të cilin fakt do ti sjelli gjykatës vërtetimin mjekësor që vërtetohet gjenda e tij shëndetësore, Andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që të aprovohet kërkesë padia në tërësi si e bazuar.

Përfaqësuesja e përkohshme e të paditurës në fjalën e saj ka deklaruar mbetëm pranë përgjigjes në padi thënë e cekura në seancat e kaluara duke shtuar se nga administrimi i provave paditësi nuk e ka provuar me asnjë provë se i ka blerë këto prona nga e paditura respektivisht të ketë krijuar ndonjë raport juridiko-civil, kjo për faktin se familjarët e të paditurit nuk kanë mundur ti bëjnë me saktësi ti identifikojnë pronat kontestuese, përjashtimisht me dëgjimin e dëshmitarit [REDACTED] e që deklarata e tij ka qenë në përputhje me shkresat e lëndës por përkundër kësaj ka theksuar se me një deklaratë duke marr parasysh natyrën e kontestit nuk është e mjaftueshme që paditësit ti njihet e drejta e pronësisë.

Ka kërkuar nga ana e gjykatës që në lidhje me kërkesë padinë e paditësit të vendos sipas ligjit, njëherit i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave sipas propozimit të palëve bëri administrimin e këtyre provave: Lexohet padia e paditësit C.nr. 295/13 dt.26.04.2013, autorizimi i paditësit dhënë av. [REDACTED] dt.13.03.2015 e dorëzuar e anë të parashtrës së dt.18.04.2016, aktvendimi mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit evidentuar me nr. C.nr. 295/13 dt.23.01.2017, e avokates [REDACTED] në tri gjuhë (shqip , anglisht dhe serbisht), përgjigja e marr nga ana e Zyrës së Komuniteteve me nr. 14/7 dt.13.02.2017, kërkesa e GJ.TH-Ferizajt dt.23.01.2017, drejtuar Zyrës së Komuniteteve në Ferizaj për sigurimin eventual të adresës së të paditurit, përgjigja në padi e paraqitur nga ana e përfaqësueses së përkohshme av. [REDACTED] dt.24.03.2017, ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë [REDACTED] dt.23.06.2017, procesverbali i dt.07.08.2017, në të cilën janë dëgjuar dëshmitarët [REDACTED] dhe [REDACTED], plotësim ekspertiza e dorëzuar nga eksperti [REDACTED] dt.04.09.2017, parashtrësia e paditësit mbi precizimin e padisë dt.05.12.2017

Bazuar në provat e administruara, vlerësimin e tyre një nga një dhe në lidhmëri me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjykata ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata konsideron se nga provat e administruara, dëgjimi i dëshmitareve, ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë daljes së gjykatës në vendin kontestues, është vërtetuar fakti se paditësi me të paditurin kishin lidhur marrëveshje gojore për shitblerjen e patundshmërive ku ishin pajtuar se çmimi kontraktues të jetë 10.000 DM, e cila ishte përmbushur në tërësi nga paditësi me të cilin edhe ishte futur në posedim të ligjshëm dhe me mirëbesim dhe nga koha e shitblerjen 1980 paditësi këto prona i mbanë në mënyrë të qetë dhe pa u penguar nga askush

Por duke marr parasysh rrethanat e kohës paditësi nuk ka mundur të bëjë bartjen e pronësisë në kohën e shitblerjes pasi që ka qenë e ndalur të bëhen transaksione të shitblerjes së patundshmërive nga pronarët të nacionalitetit serb tek shqiptarët dhe mbi të cilën rrethanë ka mbetur që paditësi pronën e blerë nga i padituri të mos ta bëjë edhe bartjen e pronësisë.

Gjykata ka gjetur se provat e administruara përputhen në tërësi me gjendjen faktike të cilën gjykata e ka konstatuar me daljen në vend, shikimi me anë të ekspertit të gjeodezisë në patundshmërinë kontestuese, ku prezentë ishin edhe dëshmitarët të cilën i bënë identifikimin e ngastrave kontestuese me të cilën gjykata ka vërtetuar se NK.nr.1202-2, në sipërf. prej 1.84.07 ha, NK.nr.1156-1 në sipër prej 0.65.10 ha², dhe NK.nr.1156-2 në sipër faqe prej 0.52.49 ha këto ngastra gjendet në vendin e quajtur "Utrina" ZK. Prelez i Jerlive, këto ngastra janë përshkruar hollësisht në procesverbalin e daljes së gjykatës në vendin kontestues me dt.08.06.2017 dhe me dt.22.08.2017, kur është bërë ri identifikimi i NK.nr.1156-1 dhe 1156-2 si dhe është përshkruar hollësisht nga ana e ekspertit të gjeodezisë [redacted] në ekspertizën e dt.23.06.2017, dhe plotësim ekspertizën e dt.04.09.2017 me përkufizime përkatëse.

Me dëgjimin e dëshmitarëve [redacted] dhe [redacted] në seancën e dt.07.08.2017, është vërtetua fakti se paditësi patundshmëritë i ka blerë nga i padituri në vitin 1982, në të cilat prona është futur në posedim të qet dhe faktik pasi që me rastin e arritjes së marrëveshjes gojore për shitblerjen e këtyre pronave paditësi e ka përmbushur në tërësi detyrimin e tij kontraktues, kjo vërtetohet me saktë nga dëgjimi i dëshmitarit [redacted] i cili në kohën e shitblerjes ka qenë sekretar i shkollës në fshatin [redacted] dhe ishte prezent me rastin e arritjes së kësaj marrëveshje.

Meqenëse dëshmitarët pas shikimit të ekspertizës së gjeodezisë nuk kanë mundur të bëjnë identifikimin e ngastrave kontestuese gjykata e ka aprovuar propozimin përfaqësueses së përkohshme të paditurit për ri daljen e gjykatës në vendin kontestues s'bashku me ekspertin e gjeodezisë dhe në prezencën e dëshmitarëve, ku dëshmitarët në teren i kanë bërë në mënyrë të saktë identifikimin e ngastrave kadastrale sipas gjendjes faktike të cilat ngastra përputhen në tërësi me gjendjen juridike, andaj duke marr parasysh këtë gjykata ua ka falur në tërësi besimin këtyre dëshmitarëve si objektiv pasi që dëshmia e tyre është përputhur në tërësi me gjendjen faktike.

Gjykata pas vlerësimit të provave lidhur me faktet ka vërtetuar se paditësi nga viti 1982 ka hyrë në posedim të ligjshëm dhe me mirëbesim në patundshmëritë kontestuese sipas marrëveshjes gojore për shitblerjen e patundshmërive dhe nga ajo kohë i njëjti i ka në posedim të qet, të vazhdueshëm dhe të papenguar nga askush, pra as nga i padituri.

Paditësi sipas bazës juridike të marrëveshjes mbi shitblerjen dhe mbajtjes me mirëbesim në kuptim të nenit 28 par.1,2 lidhur me par.4 të LTHMPJ e ka fituar të drejtën e pronësisë në NK.nr.1202-2, në sipërf. prej 1.84.07 ha, NK.nr.1156-1 në sipër prej 0.65.10 ha², dhe NK.nr.1156-2 në sipër faqe prej 0.52.49 ha këto ngastra gjendet në vendin e quajtur "Utrina" ZK. Prelez i Jerlive.

Sa i përket vërejtjeve të përfaqësueses së përkohshme të paditurit se familjarët e paditësit nuk kanë mundur të bëjnë me saktësi identifikimin e ngastrave kadastrale, gjykata konsideron se meqenëse të njëjtit janë me vendqëndrim respektivisht që një kohë të gjatë jetojnë dhe veprojnë

në shtetin e Gjermanisë dhe se paditësi nuk ka mundur të jetë prezent as në vendin e ngjarjes dhe as në njërin nga seancat gjyqësore për shkak të sëmundjes së tij të rëndë e cila vërtetohet me vërtetimin mjekësor të dt.09.10.2017, lëshuar nga QKMF Dr. [REDAKTUAR] ku është konstatua se i njëjti për shkak të sëmundjes së tij nuk mundet me lëviz nga shtrati-shtëpia andaj duke marr parasysh se dëshmitarët e kanë bërë identifikimin e saktë të ngastrave kadastrale të cilat ngastra përputhen në tërësi si me gjendjen faktike dhe me atë juridike e të cilave dëshmi gjykata ua ka falur besimin gjykata konsideron se këto vërejtje kanë qenë parimore por jo deri në atë masë sa që të vendoset në lidhje me refuzimin e pjesshëm të kërkesë padisë sa i përket NK.nr.1156-1 dhe 1156-2.

Gjykata me rastin e vendosjes ka marr parasysh edhe vërejtjet tjera të përfaqësueses së të paditurit, por të njëjtat nuk kanë qenë bazë për të vendosur ndryshe për dallim të asaj që është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së andaj obligohet paditësi që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 1.536€ dhe atë për përpilim të përgjigjes në padi shumë prej 101€, për 5 seanca të mbajtura secila nga 270 € gjithsejtë 1.350 €, për taksën gjyqësore për padi 50€ (diferencën 35€ pasi që 15€ janë të paguara) dhe për përpilim të aktgjykimit shumë prej 50€, kurse për ekspertizë janë të paguara.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.295/13 dt.31.01.2018

Gjyqtari
Alban Beqiri



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinës, përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC



28. 02 20 18